



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 12.06.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. protokolli HRELRU-0077, për zyrtarin e lartë publik z. Berat Marmullaku, Udhëheqës i Divizionit Prokurimit, Ministria e Shëndetësisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Berat Marmullaku, Udhëheqës i Divizionit Prokurimit, Ministria e Shëndetësisë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/1-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë): "[...] Sipas të dhënave të regjistrit për deklarimin e pasurisë për vitin 2024, Berat Marmullaku rezulton të jetë emëruar udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë me 09.01.2023. Me 22.08.2024, ai është emëruar në të njëjtën pozitën në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, ndërsa së fundi me 06.03.2025, është caktuar udhëheqës i prokurimit edhe në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Në bazë të regjistrit për deklarimin e pasurisë të vitit 2024, z. Berat Marmullaku ka deklaruar të ardhura vjetore prej 750 euro, të realizuara nga ushtrimi i funksionit publik si udhëheqës i prokurimit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Sipas regjistrit përkatës, nga muaji mars 2025 ai është angazhuar me pagesë mujore edhe në pozitën e udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Të shqyrtohet nëse ky angazhimi i shumëfishtë paraqet konflikt të interesit, sipas përkufizimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Të hetojë nëse janë realizuar përfitime financiare në kundërshtim me dispozitat ligjore, përkatësisht nëse pagesat për më shumë se një pozitë udhëheqëse janë të lejuara ligjërisht [...]".



Agjenci për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar ne dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia përmes shkresës zyrtare (DPKI-593/25), e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Berat Marmullaku, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më qëllim të sqarimit të plotë të pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit për zyrtarin e lartë publik z. Berat Marmullaku, Udhëheqës i Divizionit Prokurimit, Ministria e Shëndetësisë, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin në fjalë, me ç' rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit nga raportuesi i rastit.

Në takim, zyrtari i lartë publik ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, duke theksuar se: *“Fondi për Sigurim Shëndetësor është në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Fondi për Sigurim Shëndetësor brenda vitit ka 5 apo 6 aktivitet të prokurimit. Ndërsa sa i përket çështjes së kompensimit, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar nga Drejtori i Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, marr 20% të pagës bazë, me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Po ashtu Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, me qëllim të përkrahjes teknike dhe profesionale të procedurave të prokurimi dhe procedimit të urdhër blerjeve për nevojat e ASK-së. Për shërbimet të cilat i kryej marr 20% të pagës bazë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës”.*

Nga informatat që përmban kërkesa e raportuesit të rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur si dhe informacioni/dokumentacioni i siguruar, rezulton gjendja faktike si në vijim:

Me datë 26.02.2024, është nënshkruar Marrëveshja nga Drejtori i Fondit për Sigurime Shëndetësor dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, që Divizioni i prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë të udhëheq të gjitha aktivitetet e prokurimit për FSSH;

Me datë 04.03.2025, është nënshkruar Marrëveshja nga Drejtori i Fondit për Sigurime Shëndetësor, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, për vazhdimin e marrëveshjes bazë të nënshkruar me datë 26.02.2024;

Me datë 22.08.2024, Marrëveshje e Mirëkuptimi e nënshkruar në mes të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe U.d. Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Bazuar në gjendjen faktike si më lartë, diskutimit nga takimi i mbajtur me zyrtarin e lartë z. Marmullaku, si dhe dokumentacionit në dispozicion (Marrëveshja, datë 26.02.2024, Marrëveshja e datës 04.03.2025, për vazhdimin e marrëveshjes bazë të datës 26.02.2024, e nënshkruar nga Drejtori i Fondit për Sigurime Shëndetësor dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, Marrëveshja e Mirëkuptimit e datës 22.08.2024, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe U.d. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës), duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konstaton se zyrtarit të lartë parimisht nuk i ndalohet që të angazhohet si zyrtar i prokurimit në dy apo më shumë autoritete

kontraktuese, gjë që nuk është e ndaluar as me dispozitat e Ligjit për Prokurimi Publik, ku nenin 23 paragrafi 3 i këtij Ligji ka përcaktuar se:

“Dy apo më shumë autoritete kontraktuese të cilat kanë prokurime të pakta mund të arrijnë marrëveshje që të përcaktojnë personin e njëjtë si Zyrtar të Prokurimit”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit gjithashtu ka pasur parasysh dispozitën e nenit 13, paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, së cilës i është referuar raportuesi i rastit, por Divizioni i Prokurimit (në këto institucione), nuk konsiderohet organ drejtues i ‘institucionit’ (sikurse mund të jenë, p.sh.: bordet apo organet tjera drejtuese të institucioneve) në kuptim të dispozitës së sipërcituar (nenit 13, paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), prandaj e njëjta nuk mund të aplikohet në rastin konkret.


Sa i përket pretendimit të raportuesit të rastit se: *“Nëse janë realizuar përfitime financiare në kundërshtim me dispozitat ligjore, përkatësisht nëse pagesat për më shumë se një pozitë udhëheqëse, janë të lejuara ligjërish”*, pavarësisht se i njëjti (pretendim) nuk hynë në sferën e konfliktit të interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, bazuar në dokumentacionin e lëndës në dispozicion ka gjetur se z. Murrullaku është kompensuar 20% të pagës bazë nga Fondi për Sigurim Shëndetësor, në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin e Funksionit Shtesë. Po ashtu, nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, kompensohet me 20% të pagës bazë, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, deri në caktimin e nëpunësit të ASK-së në vendin e punës, për ushtrimin e detyrave të udhëheqjes së procedurave të prokurimit në këto institucione. Këto të dhëna janë konfirmuar edhe në takim me z. Murrullaku, dhe janë të specifikuara në marrëveshjet përkatëse, ajo ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor, si dhe marrëveshja e mirëkuptimit me U.d. Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

II. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll BULESHKAI
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit